



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

Për:	Ertan Munoglu – Menaxher i Programit
Nga:	Fisnik Dashi – Koordinator për Kolegjiume
Kopje:	Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv
Data :	27 prill 2011
Subjekti :	Raport nga takimi i Kryesisë së Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor

HYRJE

Kryesia e Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor me datën 27 prill mbajti mbledhjen e rregullt të saj dhe të parën për vitin 2011.

Në këtë takim ishin prezentë znj. Qazime Vata – Kryesuese, dhe anëtarët z.Sadik Paçarizi, z. Milutin Pejović z. Nebojša Kenić, znj. Mejrushe Sejdullahu, znj. Nazmije Tora dhe Xhavit Sulejmani. Në takim poashtu ishin prezent edhe z. Ertan Munoglu – Menaxher i Programit në AKK, z. Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve në AKK, dhe Shemsedin Mujko – Përkthyes .

Takimi kishte për qëllim fillimin e hartimit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2011 të Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor dhe të përcaktoj listën e prioriteteve, objektiveve, dhe aktiviteteve të Kolegjiumit, si dhe mënyrën e lobimit për përmbushjen e prioriteteve të Kolegjiumit.

PËRMBLEDHJE:

Mbledhjen e hapi znj. Qazime Vata me diskutimin e pikave të rendit të ditës:

- Përpilimi i planit të punës së kolegjiut
- Identifikimi i nevojave për trajnim
- Vizita nëpër Komunat e Kosovës për shkëmbim të përvojave
- Definimi i takimit të radhës së Kolegjiut
- Çështje tjera

Pas diskutimeve dhe debatit, Kryesia vendosi për këto prioritete dhe objektiva në realizimin e planit të punës të kolegjiut për Planifikim Hapësinor në vitin 2011.

- **Fusha e Legjislacionit** duke pasur për objektivë kompletimin e infrastrukturës ligjore si dhe Hartimi, plotësimi dhe harmonizimi i rregulloreve komunale.
- **Organizimi dhe bashkëpunimi institucional** duke pasur për objektivë ri-organizimin e Drejtorive Komunale si dhe fuqizimin e marrëdhënieve mes Komunave dhe institucioneve tjera qendrore.

Takimi kishte për objektiv edhe përcaktimin e pikave të rendit të ditës për takimin e radhës së Kolegjiut për Planifikim Hapësinor.

Takimi i radhës

Kryesia për fund vendosi që takimi i Kolegjiut për Planifikim Hapësinor të mbahet të mërkurën me datën 18.05.2011 në Gjakovë.

Agjenda e takimit është përcaktuar si vijon:

1. Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut
2. Miratimi i Rregullores së Punës dhe Planit të Punës për vitin 2011
3. Pjesëmarrje në Grupin Punues për Ligjet relevante (Ligji për kadastër dhe ai për ndërtim)
4. Analizë e organizimit të Drejtorive të Urbanizmit/Planifikimit Hapësinor/Mbrojtje të Mjedisit (nr i stafit dhe kualifikimi, emërtimi, organizimi i brendshëm, konflikt mandati për planifikim/lëshim të lejeve).
5. Identifikimi i nevojave për trajnim dhe shkëmbim të përvojave mes Komunave të Kosovës

Anëtarët ranë dakord që stafi i AKK-së të jetë përgjegjës për përgatitjen e ftesave, dhe sigurimit të ambientit ku do të mbahet mbledhja.